

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË TREGTARE  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
SAS( SOFTWARE ALBANIA SOLUTIONS) SHPK**

**NENI 1**

Në Tiranë , sot më datën 24.01.2020, unë shtetasi i poshtëshënuar , me vullnet të lirë dhe të plotë krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar:  
**SAS( SOFTWARE ALBANIA SOLUTIONS) SHPK**

**NENI 2**

Selia Qëndrore e shoqërisë "SAS( SOFTWARE ALBANIA SOLUTIONS) SHPK "do të jetë në Tiranë , Rruga "Him Kolli" , Pallati 2T,kati i parë ,1001 .

**NENI 3**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është mbi 20 vjet, duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit në QKB.  
Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim QKB-së për të bërë shënimet e nevojshme.

**NENI 4**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare "SAS( SOFTWARE ALBANIA SOLUTIONS) SHPK" është :

Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemeve software-iale.Mirëmbajtja e rrjeteve elektronike , tregu i pajisjeve elektronike . Konsulencë dhe shërbime informatike.



## NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë (njëqind mijë), formuar dhe nënshkruar nga 4( katër ortakë ).

- 1.Gjergji Bushi 1 ( një ) pjesë ose 40% të kapitalit themeltar, vlera 40,000 lekë.
- 2.Lirim Zalla 1(një ) pjesë ose 25% të kapitalit themeltar , vlera 25.000 lekë.
- 3.Shpëtim Cinga 1(një) pjesë ose 25% të kapitalit themeltar , vlera 25.000 lekë.
- 4.Fatmir Sulo 1(një) pjesë ose 10% të kapitalit themeltar , vlera 10.000 lekë.

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

## NENI 6

Kapitali Themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr Asambleja e Ortakëve i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës. Në këto raste, vendimi merret nga ortakët që përfaqësojnë 100% të pjesëve të kapitalit themeltar.

## NENI 7

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë ,të ruajnë sekretin e saj dhe të mos dëmtojnë interesat e personave të tjerë të shoqërisë.

## NENI 8


Shoqëria çel llogari bankare në lekë dhe në çdo lloj valute të huaj, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

## NENI 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- 1-Asambleja e Ortakëve
- 2-Administratori

Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe Administratorit do të përcaktohen në statutin e shoqërisë tregtare **SAS( SOFTWARE ALBANIA SOLUTIONS) SHPK**



**NENI 10**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj **Z. Lirim Zalla**

**NENI 11**

Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërtën kompetentë për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

**NENI 12**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, veçanërisht ,ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008"Per Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare të ndryshuar.

**NENI 13**


Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas regjistrimit në QKB.

**NENI 14**


Akti i themelimit u përpilia ne 4(katër ) kopje dhe u nënshkrua regullisht nga ortakët themelues.

**THEMELUES TË SHOQËRISË  
SAS( SOFTWARE ALBANIA SOLUTIONS) SHPK**


Gjergji Bushi



Lirim Zalla



Shpëtim Cinga



Fatmir Sulo

